



**Hapet Thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+
në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në UAS in Nysa

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Të kenë përfunduar një vit akademik, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Kohëzgjatja e bursave: Për studentë: 1 semestër, semestri i dytë i vitit akademik 2026 – 2027

Fushat e studimit: Arkitekturë

Numri total i studentëve: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Applied Sciences In Nysa, Poloni, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në Applied Sciences in Nysa, Poloni, ju lutemi klikoni te linku:



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –



<https://pans.nysa.pl/org/ico/strona/students-1>

Afati për aplikim: Deri më 15 tetor 2026

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:
rkodra@upt.al , abeqo@upt.al